



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 826/20 prot.

Tiranë, më 25.10. 2022

V E N D I M

Nr. 195, datë 25.10. 2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”², të ndryshuar, shqyrtoi ankesën Nr. 90 regj, datë 02.06.2022 të paraqitur nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, në emër të shtetasve S.F dhe J. M kundër Shoqërisë “F.D.A. LINE BUS” sh.p.k, me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, pretendohet se, S.F, President i Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” dhe J.M, Kryetar i Shoqatës, Dega Durrës, në datën 24.05.2022, kanë udhëtuar me linjën e transportit publik Golem-Plepa, për të shkuar për inspektim në plazhin që është ndërtuar për personat me aftësi të kufizuara, afër Hotel Murrizi. Gjatë udhëtimit këta persona deklarojnë se, nga linja e transportit publik i’u është kërkuar të paguajnë biletën e plotë, duke mos i’u njohur e drejta për të udhëtuar sipas parashikimeve të ligjit nr.8098, datë 28.03.1996.

Pala ankuese kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për të ndaluar këtë lloj diskriminimi, i cili pengon jetën normale të personave me aftësi të kufizuar.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, është një organizatë jofitimrurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr.6179, datë 07.03.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj të verbër. Bazuar në ankesën e paraqitur, pala ankuese nuk pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, si person juridik, por pretendon diskriminimin e shtetasve S.F, i cili është Kryetar i Shoqatës “Shpresë për të Verbërit” dhe z. J.M, Kryetar i Degës Durrës të Shoqatës.

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “b”, të LMD, përcaktohet: “1. Komisioneri ka kompetencë:b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;.....”, ndërsa pika 2, e nenit 33, të LMD, sanksionohet se: “2. Organizata me interesa legjitime mund të kërkojnë kryerjen e hetimeve administrative nëpërmjet disponimit të informacionit të besueshëm, si dhe të përfaqësojnë një person ose grup personash, pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim ose të mbahet procesverbal në prani të një punonjësi të institucionit, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave.”

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: “Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.”

Në bazë të akteve të administruara rezulton se, personat të cilët pretendojnë se janë diskriminuar dhe në emër të të cilëve, Shoqata “Shpresë për të verbërit” ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi kanë dhënë pëlqimin e tyre me shkrim për paraqitjen e kësaj ankese.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, Shoqata “Shpresë për të verbërit” legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi para Komisionerit, në emër të S. F dhe J. M.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës rezultoi se, pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin, i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Golem-Plepa, me të cilën S.F dhe J.M, kishin udhëtuar në datën 24.05.2022, datë në të cilën peretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i'u është drejtuar për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim, disa institucioneve, Bashkia Kavajë, Bashkia Durrës dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Me shkresën nr. 5830/1 prot., datë 31.08.2022, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“Referuar Urdhrit nr. 318, datë 02.11.2020, “Për delegim kompetence”, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), është organi kompetent për lëshimin e licencave dhe certifikatave në transportin ndërqytetës, mbi bazën e rrjetit të linjave të miratuar me udhëzim të Ministrit përgjegjës për transportin rrugor. Subjekti transportues “F.D.A. Line Bus” sh.p.k, është licencuar nga DPSHTRR për të operuar në linjën e transportit ndërqytetas të udhëtarëve me autobus, Golem-Durrës dhe anasjelltas, sipas orareve të përcaktuara”.*

Pas plotësimit të ankesës dhe identifikimit të subjektit transportues Shoqëria “F.D.A. LINE BUS” sh.p.k., u konstatua se nga pikëpamja formale, ankesa objekt shqyrtimi plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 dhe 334 të LMD. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj, duke ndërmarë hapat e mëposhtme:

1. Me shkresën nr. 1213/1 prot., datë 08.09.2022, Komisioneri, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shoqëria Shoqëria “F.D.A. LINE BUS” sh.p.k. dhe DPSHTRR, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

1.1 Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Shoqëria “F.D.A. LINE BUS” sh.p.k., me shkresën e datës 15.09.2022³, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se:

Shoqëria “F.D.A.LINE BUS” sh.p.k, operon prej vitit 2010 në sektorin e transportit të udhëtarëve duke kryer transportin e udhëtarëve në linjat ndërqytetase Durrës-Golem-Durrës dhe Golem-Durrës-Golem. Aktualisht, shoqëria zotëron licencën me nr. 2, datë 05.05.2022, për operim në linjën ndërqytetëse Durrës-Golem-Durrës dhe licencën me nr. 3, datë 05.05.2022, për operim në linjën Golem-Durrës-Golem.

Në ushtrimin e aktivitetit të saj, shoqëria zbaton rregullat e parashikuara nga legjislacioni aktual në fuqi për sa i përket çmimit të biletave. Konkretisht çmimi i biletës së udhëtimit përcaktohet në VKM nr. 66, datë 07.02.2007, i ndryshuar, në bazë të distancës në kilometra. Në legjislacionin aktual në fuqi parashikohen rregulla të veçanta për transportin e personave që përfitojnë nga ligje të veçanta, konkretisht neni 11, i ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për statusin e të verbërit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Të verbërit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompesim për shërbimin e transportit. Masa kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me Vendim të*

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1213/2 prot., datë 16.09.2022.

Këshillit të Ministrave”. Neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*”, i ndryshuar, përcaktohen se, udhëtarët që përfitojnë lehtësi nga ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta. Aktualisht nuk ka një vendim ku të përcaktohen rregullat për kompesimin e personave që përfitojnë nga statusi i të verbërit dhe si do të bëhet kompesimi i çmimit të biletave.

Pavarësisht vakumit ligjor ku nuk ka përcaktim për mënyrën e rimbursimit të çmimit të biletave, shoqëria, si një shoqëri me përgjegjësi të lartë shoqërore, me qëllim primar ofrimin e shërbimit me cilësi sa më të mirë, gjithmonë ka mbuluar udhëtimin falas të këtyre personave. Kostoja e udhëtimit të këtyre personave është mbuluar gjithmonë nga shoqëria, pavarësisht se nuk ka parashim ligjor për kompesimin dhe deri në këtë moment nuk ka patur asnjë rimbursim si për shoqërinë e transportit ashtu edhe për personat që përfitojnë nga statusi i të verbërit. Me shërbim mbulohen jo vetëm për personat që përfitojnë nga ligje të veçanta, por edhe për policët apo persona të tjerë që janë dukshëm që ndodhen në vështirësi ekonomike. Gjithmonë nga ana jonë janë orientuar punonjësit (faturino/shoferë/përgjegjës turni) që këta persona të udhëtojnë falas.

Për sa i përket rastit konkret, nga pyetja që i është bërë fatorinove/shoferave të linjës, nuk rezulton se ka patur persona/shoqëruesit e tyre, të cilët kanë paraqitur librezën e statusit të të verbërit ose kanë qenë dukshëm persona që përfitojnë nga ky status dhe nga ana e tyre u është kërkuar pagimi i biletës.

1.2 Me shkresën nr. 20835/1 prot., datë 21.09.2022, DPSHTRR, ktheu përgjigje duke informuar ndër të tjera Komisionerin se:

DPSHTRR, në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 318, datë 02.11.2020 “*Për delegim kompetence*”, është organi kompetent për nënshkrimin e licencave dhe certifikatave për transportin ndërqytetës të udhëtarëve me autobus. Në linjën e transportit ndërqytetës Durrës-Golem-Durrës dhe Golem-Durrës-Golem, është licencuar Shoqëria “F.D.A.LINE BUS” sh.p.k, në bazë të licencave nr. 2 dhe nr. 3, datë 05.05.2022.

Aktualisht shoqëritë e transportit ndërqytetës nuk përfitojnë subvencion për transportin e udhëtarëve që duhet të përfitojnë falas. Kjo është një problematikë që vazhdimisht është parashtruar nga shoqatat e transportit ndërqytetës tek institucionet përgjegjëse për nxjerrjen e akteve ligjore/nënligjore përkatëse.

Për sa i përket kontrollit të transportit për shpërndarjen e biletave, DPSHTRR nuk ka kompetenca kontrolli në terren për shpërndarjen e biletave në transportin ndërqytetës. Në zbatim të VKM nr. 85 datë 08.02.2017 “*Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor*”, i ndryshuar, Kreu I, pika 10, përcaktohet se: “10. Strukturat përkatëse tatimore ushtrojnë kontroll ndaj shoqërive rezidente shqiptare, të licencuara, për llojet e ndryshme të transporteve, për pajisjen me bileta të udhëtarëve ose faturë tatimore, vetëm apo në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për transportin dhe strukturat e

Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përputhje me kompetencat dhe detyrat e tyre funksionale”.

Organi i specializuar për kontrollin në rrugë të shoqërive të transportit rrugor, në varësi të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të VKM nr. 465, datë 26.07.2018, i ndryshuar është Task-Forca e Transportit Rrugor.

2. Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: “ 8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri në datën 11.10.2022 ora 10:00, zhvilloi një seancë dëgjimore publike.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces. Pala ankuese u përfaqësua nga z. S. F dhe z. J.M; Shoqëria “F.D.A LINE BUS” sh.p.k., u përfaqësua, Avokat K.D, Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë me Nr. Licence 4229, sipas autorizimit të lëshuar në datën 11.10.2022, nga Administratori i Shoqërisë “F.D.A LINE BUS” sh.p.k., z. A. K si dhe z. Arjan Kapo, Drejtues Teknik i Shoqërisë; DPSHTRR, u përfaqësua nga znj. J.Dh dhe z. S.H, me detyrë jurist, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas autorizimit nr. 22585/1 prot., datë 05.10.2022, të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPSHTRR.

Gjatë seancës dëgjimore, pala ankuese ngriti shqetësimin e mosrespektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar nga ana e shoqërive të transportit dhe kërkuan me forcë respektimin e këtyre të drejtave dhe trajtimin me respekt të personave me aftësi të kufizuar. Shoqëria “F.D.A LINE BUS” sh.p.k. theksoi se ajo ishte plotësisht e angazhuar për të respektuar të gjitha detyrimet ligjore në raport me personat me aftësi të kufizuar dhe për të mos lejuar shkeljen e tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Bazuar në pikën 9, të nenit 33, të LMD, përcaktohet se: “9. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa.”

Bazuar në këtë kompetencë ligjore, si dhe duke vlerësuar qëndrimin e palëve gjatë seancës dëgjimore, Komisioneri iu parashtrroi palëve nëse ata mund të arrinin një marrëveshje me pajtim në lidhje me problematikën e parashtruar.

Gjatë seancës dëgjimore, pala ankuese deklaroi se ishte dakort për zgjidhjen e çështjes me pajtim dhe arritjen e një marrëveshje me Shoqërinë “F.D.A LINE BUS” sh.p.k. Duke vlerësuar angazhimin e Shoqërisë “F.D.A LINE BUS” sh.p.k. për të respektuar dhe mos lejuar asnjë shkelje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar gjatë aktivitetit të ushtruar nga ana e saj, pala ankuese deklaroi se e konsideronte problematikën e adresuar nëpërmjet ankesës objekt shqyrtimi të zgjidhur dhe se tërhiqej nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëron se qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb dhe pala ankuese gjatë seancës dëgjimore të datës 11.10.2022 deklaroi tërheqjen nga ankesa, pasi e konsideronte problematikën e adresuar pranë Komisionerit si të zgjidhur.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 90 regjistri, datë 02.06.2022, të paraqitur nga pala ankuese Shoqata “Shpresë për të Verbërit” në emër të z. S.F dhe z. J. M kundër Shoqërisë “F.D.A LINE BUS” sh.p.k., duhet të deklarohet e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.90 Regjistri, datë 02.06.2022, pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Rekomandohet Shoqëria “F.D.A LINE BUS” sh.p.k, që me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masat e mëposhtme:

- Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të ushëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për ofrimin e udhëtimit pa pagesë për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
 - Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
 - Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.
3. Shoqëria “F.D.A LINE BUS” sh.p.k, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme.
 4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Fusha: Shërbime/Transport
Lloji i vendimit: Arritje qellimi